



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATURA E SHETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 308/19 Prot.

Tiranë, më 02.06.2026

URDHËR:
Nr. 376 datë 02.06.2026
PËR

**NGRITJEN E KOMISIONIT PËR KRYERJEN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT
TË FIGURËS SË KANDIDATËVE TË SHPALLUR FITUES NË PROVIMIN E
PRANIMIT NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS 2026-2027
PËR POZICIONIN AVOKAT SHTETI NË NIVEL VENDOR**

Në mbështetje të neneve 6, germa "a", dhe 20 të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar midis Avokaturës së Shtetit dhe Shkollës së Magjistraturës me nr. 380/2 prot., datë 10.02.2025, shkresës nr. 786 prot., datë 21.05.2026, të Shkollës së Magjistraturës, si dhe urdhrit nr. 330, datë 05.06.2025, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit për kryerjen e procedurës së verifikimit të figurës së kandidatëve të shpallur fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për pozicionet "Avokat Shteti" në nivel vendor ose pranë ministrive, me këtë përbërje:

- znj. Florinda Ibrahim - Avokat Shteti pranë Zyrës së Përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhin ndërkombëtar - Kryetare;
- znj. Erinda Misho - Avokat Shteti pranë Zyrës së Përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhin ndërkombëtar - Anëtare;
- znj. Anjeza Koleka - Specialist i Burimeve Njerëzore pranë Avokaturës së Shtetit - Anëtare.

2. Komisioni të kryejë procedurën e verifikimit të figurës së kandidatëve për avokat shteti sipas urdhrit nr. 330, datë 05.06.2025, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit dhe legjislacionit në fuqi.

3. Komisioni të kryejë njoftimin e kandidatëve për fillimin e procedurës së verifikimit të figurës, për kryetarin dhe anëtarët e komisionit, si dhe për të drejtën që kanë për të kërkuar

përrjashtimin e tij dhe/ose të çdo anëtarit tjetër të komisionit, jo më vonë se 3 (tre) ditë nga njoftimi ose nga marrja e dijeni e shkakut të përrjashtimit.

4. Komisioni t'u dërgojë kandidatëve në rrugë elektronike:

- formularët e deklarimit dhe vetëdeklarimit;
- formularin autorizues për dhënien e miratimit për përrpunimin e të dhënave personale;
- formularin autorizues për verifikimin, pranë çdo subjekti publik dhe privat, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të të dhënave që lidhen me verifikimin e figurës së kandidatëve.

5. Komisioni të përrgatisë shkresat standarde për kërkimin e informacionit nga subjektet publike dhe private, si dhe të shpjegimeve përrkatëse nga kandidati, në lidhje me verifikimin e figurës.

6. Në përrfundim të procedurës së verifikimit të figurës, Kryetari i Komisionit të paraqesë relacionin përrfundimtar me përrshkrimin e të dhënave që rezultojnë për çdo kandidat, në lidhje me verifikimin e figurës dhe projektvendimin përrkatës të verifikimit.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri:

- znj. Florinda Ibrahim, Avokat Shteti;
- znj. Erinda Misho, Avokat Shteti;
- znj. Anjeza Koleka, Specialiste e Burimeve Njerëzore;

8. Ngarkohet Zyra e Arkivit dhe Protokollit për komunikimin e këtij urdhri dhe specialisti i IT-së për publikimin e këtij urdhri në faqen elektronike zyrtare të Avokaturës së Shtetit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas publikimit në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit.

AVOKAT I PËRRGJITHSHËM I SHQIPËRIE

ODISE MOÇKA

